



UNIVERSITETI JUSTINIANI I
FAKULTETI I DREJTËSISË

UNIVERSITETI JUSTINIANI I PARE
FAKULTETI DREJTËSIE

RREGULLORE E PROGRAMIT
DIPLOME E NIVELIT TE DYTE
DND ne JURIDIK

Tirane 2008

KREUI DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Objekti i rregullores

Rregullorja e Brendshme e studimeve te Ciklit te Dyte, Diplome e Nivelit te Dyte vendos rregullat normative te funksionimit te DND- ne Juridik dhe te marredhenieve qe krijohen midis subjekteve pjesemarrese ne veprimtarine e DND- ne Juridik . Rregullorja percakton misionin, strukturen e brendshme dhe menyren e funksionimit te DND- ne Juridik , te drejtit dhe detyrimet e organeve drejtuese, personelit akademik dhe administrativ, studenteve, bashkepunetoreve te jashtem, raportet midis tyre, rregullat per pranimin e studenteve, mesimdhenien, kerkimin, praktiken, vleresimin, diplomimin, publikimet, per krijimin dhe administrimin e te ardhurave, rekrutimin e personelit dhe parashikon sanksionet ne rastin e shkeljes se rregullores.

Neni2

Qellimi i rregullores

Rregullorja ka si qellim te siguroje kuadrin e brendshem juridik, te nevojshem per mbarevajtjen e veprimtarise se DND- ne Juridik

Neni3

Baza ligjore

Baza ligjore e kesaj rregulloreje eshte neni 102 i Kushtetutes, ne zbatim te ligjit nr.9741, dt.21.05.2007 "Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Udhezimit Nr.14, dt. 03.04.2008 "Per hapjen dhe organizimin e programeve te studimit te ciklit te dyte ne institucionet publike te arsimit te larte", Udhezimit Nr.15, dt. 04.04.2008 "Per organizimin e studimeve ne IPAL", sipas se cilave institucionet e arsimit te larte duhet te pergatisin rregulloren perkatese.

Neni 4

Subjektet

Subjektet e kesaj rregulloreje jane organet drejtuese, personeli akademik dhe administrativ, keshillat dhe komisionet, studentet dhe bashkepunetoret te jashtem.

Neni 5

Statusi i DND-ne Juridik

1. DND- ne Juridik eshte pjese e Ciklit te Dyte te Studimeve ne strukturen akademike te Fakultetit te Drejtësisë te' Universitetit Justinianit te Pare .
2. DND- ne Juridik eshte shkolle 2 vjecare me kohe te plote, e cila merr persiper te ofroje studime te thelluara ne fushen e shkencave te juridikut.
3. Per mbarevajtjen e veprimtarise se DND- ne Juridik kane pergjegjesite perkatese Rektorati i Universitetit, Fakulteti i Drejtësisë , Departamentet e Fakultetit.

Neni 6

Misioni i DND-ne Juridik

1. Pregatitja e specialisteve te shkencave te juridikut
2. Pregatitja e specialisteve te vleresimit te se drejtes ne shqiperi
3. Pregatitja e specialisteve per njohjen e se drejtes europiane dhe nderkombetare
4. Pregatitja e kualifikimit shkencor ne MND, studime doktorate etj.

Neni 7

Veprimtaria e DND-ne Juridik

1. Studime te thelluara per shkencen e juridikut ne pergjithesi, per vleresimin dhe njohjen sa me te mire te legjislacionit shqiptar dhe atij nderkombetar dhe permisimit net e ardhemn e legjislacionit shqiptar duke synuar pershtajen e tij me legjislacioni e BE .
2. Njohuri mbi te drejten ne pergjithesi por dhe te konventave vendase dhe konventat nderkombetare.

Neni 8 Parimet

1. DND- ne Juridik e zhvillon veprimtarine e saj ne baze te parimeve te: lirise akademike, autonomise institucionale, cilesise.
2. *Liria akademike* nenkupton mungesen e nderhyrjes nga jashte, te censures dhe te barrierave ne praktiken e veprimtarise akademike. Ajo veshetrohet si nje parakusht per mendimin kritik, krijues si dhe per avancimin e dijeve dhe te kerkimit intelektual.
3. *Autonomia institucionale* i referohet shkalles se veterregullimit dhe te pavaresise se saj, sipas se ciles:
 - a) miraton vete strategjine e zhvil limit;
 - b) miraton vete programet mesimore;
 - c) ngre keshilla dhe komisione per realizimin e misionit te saj;
 - d) ka te drejten e perdorimit te ndertesave dhe te pasurive te tjera te dhena nga Universiteti i Tiranës ose dhurues te ndryshem sipas legjislacionit ne fuqi.
4. Parimi i *cilesise* nenkupton zbatimin e standardeve akademike, kerkimore, menaxhuese, te infrastruktures si ne aspektin e kerkesave edhe te pritshmerive, te cilat duhet te plotesohen per te arritur idealin e persosmerise. Zbatimi i parimit te cilesise nenkupton realizimin e vleresimit te brendshem, te vetevleresimit, te vleresimit te jashtem dhe te akreditimit, duke synuar permiresimin, ndryshimin, perparimin dhe njohjen zyrtare te cilesise se DND- ne Juridik .

KREUII ORGANIZIMI DHE DREJTIMII DNDJurist

Neni 9

Struktura e DND-ne Juridik

DND- ne Juridik ka kete strukture organizative:

1. Organet drejtuese
 - a. Fakulteti i Drejtesise
2. Autoriteti drejtues
Dekani i Fakultetit
3. Komisionet
4. Personeli akademik

Neni 10

Detyrat e Organit Drejtues

Grupi Mesimor Kerkimor ka keto detyra:

Miraton Rregulloren e brendshme te DND- ne Juridik .

- a) Miraton strategjine e zhvillimit.
- b) Propozon planin mesimor, te cilin ia paraqet per diskutim Keshillit te Fakultetit dhe per miratim Senatit Akademik.
- c) Miraton strukturen e studimeve.
- d) Miraton programin e kerkimeve te DND- ne Juridik .
- e) Miraton kriteret e pranimit te studenteve dhe ndjek zbatimin e tyre.
- f) Miraton projektet e DND- ne Juridik .
- i) propozon Pergjegjesit te Departamentit dhe Dekanit vendosjen e lidhjeve me shkollat analoge te vendeve te huaja, anetaresimin ne shoqata kombetare e nderkombetare qe kane si objekt ceshtje te arsimit te larte dhe

te integritet evropian.

h) I paraqet çdo vit mesimor raportin e veprimtarise se DND-ne Juridik Dekanit te Fakultetit

Neni 11

Drejtuesi i DND-ne Juridik

Dekani i fakulteti te drejtesise eshte drejtuesi i DND-ne Juridik . Ai pergjigjet per permbushjen e misionit te DND-ne Juridik dhe ka pergjegjesi te drejperdrejte per veprimtarine e gjithanshme te saj. a.Drejton punen per hartimin, ndryshimin e Rregullores se DND-ne Juridik ; per pergatitjen e strategjise se zhvillimit; per pergatitjen e dokumentacionit pedagogjik te DND-ne Juridik : planin mesimor, programet mesimore, paketen e praktikes dhe te udhezimeve per tezen; per hartimin e planit te kerkimit, per administrimin e te ardhurave te DND-ne Juridik . b.Propozon per miratim programet mesimore. c.Miraton programin e lendeve mesimore d.Drejton hartimin e orarit te mesimeve, te provimeve dhe ndjek zbatimin e tyre.

e. Miraton komisionet e provimeve.

f. Ndjek ecurine e procesit mesimor.

g.Ndjek ecurine e veprimtarise kerkimore dhe te procesit te tezes.

h.Organizon ceremonine e diplomimit.

i. I propozon Keshillit te fakultetit kriteret e pranimit te studenteve,

j. I propozon Rektorit komisionet e pranimit te studenteve, komisionin e tezes, komisionet e diplomimit.

k.Organizon konkursin e pranimit te studenteve te rinj.

l. Perfaqeson DND-ne Juridik ne marredheniet me te tretet.

m. Organizon vleresimin e brendshem te DNDJurist .

Neni 12

Komisionet

Pergjegjesat e departamentit ngre komisione qe kryejne detyra te caktuara lidhur me pranimin e studenteve, me zhvillimin e provimeve, me pergatitjen dhe mbrojtjen e tezes, me strategjine e zhvillimit te DND-ne Juridik etj. Komisionet miratohen nga Dekani.

Neni 13

Personeli akademik

1. Personeli akademik perbehet nga profesorati qe zhvillon mesim ne DND-ne Juridik . Ne DND-ne Juridik , si rregull, pranohen te japin mesim profesore, docente, lektore.
2. Pedagoget e huaj pranohen ne baze te" marreveshjeve dypaleshe. Pedagoget vizitore propozohen nga Dekani dhe miratohen nga senati.
3. Per cdo vit mesimor secili pedagog nenshkruan nje kontrate pune me Dekanin e Fakultetit , ku jane parashikuar detyrimet e pedagogut, angazhimet ne DND-ne Juridik dhe shperblimi i tij.
4. Te drejtat dhe pergjegjesite e pedagoqeve:
 - a. Te perdorin te gjitha mjediset dhe pajisjet e institucionit per veprimtari ne dobi te DND-ne Juridik
 - b. Te marrin pjese ne komisione dhe veprimtari te ndryshme te DND-ne Juridik .
 - c. Te kualifikohen ne kuadrin e projekteve te DND-ne Juridik .
 - d. Te zbatojne kontraten e punes.
 - e. Te zbatojne Rregulloren e DND-ne Juridik dhe te U. Justiniani I-se.
 - f. Te bashkeveprojne ne nje menyre profesionale, qytetare me koleget, studentet dhe bashkepunetoret e DND-ne Juridik dhe fakultetit.
 - g. Te realizojne programin mesimor sipas kerkesave te paracaktuara.
 - h. Te krijojne nje klime bashkepunimi me studentet dhe koleget.

i. Te permbushin pergjegjesite per udheheqjen e tezes.

j. Te vleresojne studentet ne menyre profesionale dhe ne kohen e parashikuar.

Neni 14

Sekretari i departamentit

- a. Punon nen drejtimin e Pergjegjesit te Departamentit dhe mban pergjegjesi per zbatimin e te gjitha porosive te dhena prej tij per komunikimin shkresor e gojor me Dekanatin, me personelin akademik, me studentet, me bashkepunetoret e institucionit. b. Ben organizimin teknik te mbledhjeve te Organit Drejtues dhe mban procesverbalin e mbledhjeve. c. Ndhmon ne pergatitjen e materialeve per Pergjegjesin e Departamentit. d. Pret personat qe kerkojne takim me Pergjegjesin e Departamentit. e. Merr ne dorezim korrespondencen dhe materiale te tjera qe vijne ne adrese te Pergjegjesit te Departamentit. f. Arkivon dokumentacionin e departamentit, te pedagogeve dhe te studenteve. g. Shtyp dhe shumefishon shkresa dhe materiale mesimore. h. Ndjek ecurine e procesit mesimor ne drejtim te respektimit te struktures mesimore, te orarit te mesimit, te provimeve; ecurine e praktikës, te procesit te tezës dhe kujdeset per mbajtjen e dokumentacionit perkates te ketyre proceseve. i. Afishon strukturen mesimore, orarin e mesimit, datat e provimeve, datat e praktikës, te mbrojtjes se tezave dhe lajmerime per veprimtari te ndryshme.

Neni 15

Sekretari Mesimor

- a. Kryen procesin e regjistrimit te studenteve te rinj gjate konkursit te pranimit si dhe proceduren e regjistrimit te studenteve te pranuar.
b. Pajis te gjithë studentet e rinj te pranuar ne DND- ne Juridik me karte studenti, ploteson kerkesat e studenteve per vertetime te thjeshta, liste notash e dokumente te tjera.
c. Pergatit procesverbalet e vleresimeve me emrat e studenteve dhe ia paraqet Komisionit per nenshkrim.
d. Merr ne dorezim procesverbalet e plotesuara te vleresimeve.
e. U jep informacion per vleresimin studenteve.
f. Kryen hedhjen e notave ne regjistrin themeltar sipas kurseve dhe lendeve; pergatit diplomat dhe certifikatat e notave per studentet qe mbarojne smdimet.
g. Mban lidhje me Dekanatin dhe raporton te dhenat statistikore te DND-ne Juridik ne instancat qe i kerkojne.
h. Merr masa per ruajtjen dhe mbrojtjen e dokumentacionit nga rreziket e ndryshme si zjarri, uji, demtimet, shperdorimet, etj.

Neni 16

Struktura e studimeve

1. Viti akademik fllon javen e pare te tetorit dhe mbaron me 30 shtator te vitit pasardhes.
2. Programi i DND-ne Juridik realizohet ne 2 vite, ndare ne 4 semestra, gjate te cilit studenti fiton 120 kredite dhe realizon 3000 ore pune.
3. Menyra e realizimit te DND-ne Juridik eshte me kohe te plote.
4. Ne ditet e festave nuk ka mesim dhe as provime.

Neni 17

Format e mesimit

1. Veprimtaria mesimore realizohet nepermjet oreve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, ushtrimeve, detyrave te kursit, prezantimeve, projekteve te kerkimit, praktikës.
2. Frekuentimi i oreve teorike dhe praktike eshte i detyrueshem ne masen 80%.
3. Kohezgjatja e seancave mesimore eshte 60 minuta.

Neni 18

Punimi i diplomes

1. Per te fituar diplomen ne DND- ne Juridik studenti duhet te mbroje nje punim diplome.
2. Per punimin e diplomes jane caktuar 16 kredite.
3. Per te fituar te drejten e mbrojtjes se punimit te diplomes studenti duhet:
 - a. Te kete marre vleresime pozitive ne te gjitha lendet mesimore dhe ne praktike, duke marre 90 kreditet e nevojshme;

KREU III

VLERESIMII STUDENTIT

Neni 19

Procedura dhe kritere te vleresimit

1. Format dhe kriteret e vleresimit te studentit percaktohen, ne programin e lendes dhe i behen te ditura studenteve.
2. Vleresimi ne nje lende mund te behet: a) me provim me shkrim, me goje ose i kombinuar; b) me detyra kursi, projekte; c) i bazuar ne nje shumellojshmeri formash vleresimi.
3. Vleresimi per secilen lende mesimore kryhet pas perfundimit te saj me sistemin e notave, ku 5 eshte nota minimale kaluese dhe 10 ajo maksimale.
4. Shkalla e pervesimit te programit mesimor vleresohet me sistemin prej dhjete notash. Notat nga 5 elart jane kaluese.
5. Vleresimi i punimit te diplomes behet me sistemin e notave.
6. Kandidati qe nderpret DND-ne Juridik ose qe nuk fiton kreditet e duhura, ka te drejte ta vazhdoje ate ne vitin pasardhes.
7. Diploma ne DND-ne Juridik i jepet kandidatit qe realizon me sukses detyrimet e planit mesimor, perfshire dhe mbrojtjen e punimit te diplomes.

Neni 20

E drejta per te hyre ne provim

1. Studenti fiton te drejten te futet ne provimin e nje lende kur ka shlyer detyrimet qe lidhen me ate lende, te parashikuara per shlyerje ne planin mesimor.
2. Studenti nuk mund te hyje ne te njejten dite ne dy provime ne lende te ndryshme.

Neni 21

Zhvillimi i provimeve

1. Provimet dhe riprovimet, detyrat e kursit dhe prezantimet zhvillohen brenda afatit te caktuar ne strukturen e vitit akademik. Datat e tyre shpallen qe ne fillim te vitit akademik.
2. Ne rast pamundesie te jashtezakonshme te zhvillimit te provimit ose te prezantimit ditën e caktuar, Pergjegjesi i Departamentit, me propozim te Pergjegjesit te lendes, cakton me urdher me shkrim nje date tjeter te mevonshme, e cila u behet e njohur studenteve dhe komisionit.
3. Lendet e zhvilluara nga nje pedagog vleresohen vetem prej tij, ndersa kur lenden e zhvillojne disa pedagogje te gjithë ata jane anetare te komisionit te vleresimit.

Neni 22

Komunikimi i vleresimeve

1. Vleresimet per lende te vefanta komunikohen nga Komisioni i Provimit.

Neni 23

Dokumentimi i vleresimeve

1. Vleresimet dokumentohen ne Procesverbalin e Vleresimit dhe ne Regjistrin e Rezultateve.

2. Procesverbali i Vleresimit plotesohet nga pedagogu ne perfundim te procesit te vleresimit dhe dorezohet ne sekretari jo me vone se 5 dite nga dita e provimit ose e prezantimit te detyres se kursit.
3. Ne asnje rast Procesverbali i Vleresimit nuk duhet te kete korrigjime dhe askush nuk ka te drejte te shtoje emra ne te.
4. Procesverbali duhet te permbaje: firmen e pedagogeve te lendes, Sekretares dhe te Dekanit ose Zv. Dekanit
5. Nje note e raportuar mund te ndryshoje vetem nese rezulton se eshte bere nje' gabim gjate regjistrimit ose gjate hedhjes ne kompjuter. Pedagogu duhet te dorezoje nje vertetim me shkrim ku pranohet gabimi. Vertetimi miratohet nga Pergjegjesi i Departamentit. Ndryshimi pranohet brenda nje periudhe kohore prej tri ditesh nga data e dhenies se vleresimit.

KREU IV

PRANIMI STUDENTEVE

Neni 24

Politika e pranimit

1. Cdo vit akademik, per te ndjekur DND-ne Juridik pranohen studente nga Shqiperia, Kosova, Presheve-Bujanovca, ish Republika Jugosllave e Maqedonise, Serbia e Mali i Zi dhe nga vende te tjera nese kandidatet zoterojne gjuhen shqipe.
2. Programi per studime per DND-ne Juridik synon te jete nje kurs i hapur per te gjithë studentet qe kane nje diplome te ciklit te pare dhe diplome e sistemit te vjeter te universiteteve te vendit ose te huaja.
3. Hapja e DND - ne Juridik ndjek kete procedure: propozohet nga Fakulteti i Drejtesise , i percillet per diskutim Keshillit te Fakultetit dhe per miratim Sentatit Akademik te Justinianit te pare .
4. Hapja e fushates per pranime ne DND-ne Juridik do te behet nga dt. 1-30 shtator te vitit perkates.
5. DND-ne Juridik do te drejtohet prej fakulteti te drejtesise , nen mbikqyrjen e rektorit .
6. Kandidateve u ofrohet paketa e DND-ne Juridik , ku perfshihen: plani mesimor, stafi akademik, koha e realizimit, koha e pergatitjes dhe mbrojtjes se mikrotezes.
7. Kerkesa per pranimin ne DND-ne Juridik dorezohet nga i interesuari, me firme dhe protokollim ne sekretari, perkundrejt leshimit te nje vertetimi dorezimi.
8. Pranimi i kandidateve behet me konkurrim, nese numri i kerkesave eshte me i madh se kuota e pranimit.
9. Perzgjedhja e kandidateve bazohet ne parimet e barazise, te drejtesise, te paanesise dhe te merites qe nenkupton vleresimin teresor te treguesve te kandidatit.
10. Organizimi i konkursit te pranimit behet nga Dekani i fakultetit mbi bazen e Rregullores se Brendshme dhe te vendimeve te autoriteteve drejtuese te institucionit.
11. Per perzgjedhjen e kandidateve vepron Komisioni i Vleresimit, i cili i paraqet per miratim dekanit te listen e kandidateve fitues. Pergjegesi i Departamentit shpall listen e kandidateve te pranuar.
12. Kandidati qe nuk eshte perzgjedhur mund t'i drejtoje ankese rektorit brenda dy diteve nga dalja e vendimit. Rektori , nese e sheh te drejte, i propozon Dekanit ngritjen e nje komisioni rivleresimi, vendimi i te cilit eshte i formes se prere.
13. Lista perfundimtare shpallet dy jave para fillimit te vitit akasdemik.
14. Kandidati qe nuk ka fituar nje here mund te konkurroje perseri ne vitin e ardhshem.

Neni 25

Procedurat e pranimit

1. Pranimi i dokumentacionit
 - a. Grumbullimi i dosjeve fillon ne periudhen 20 gusht -20 shtator.
 - b. Te gjitha dokumentet per konkurrim duhen dorezuar nga vete i interesuari ne sekretarine e Departamentit.
 - 'c. Nuk pranohet dergimi i dokumenteve me e-mail, fax ose poste..
2. Procedura e perzgjedhjes se kandidateve dhe e komunikimit te vendimit
 - a. Procesi i shpalljes se fituesve duhet te perfundoje deri me 30 shtator.

- b. Procedura e perzgjedhjes ndahet ne keto faza:
- c. Pergjegjesi i Departamentit propozon Komisionin e Pranimit, i cili miratohet nga Dekani, dhe qe ka per detyre te perzgjedhe kandidatet, duke i vleresuar treguesit e tyre sipas kriterëve te pranimit.
- d. Bazuar ne rezultatet e vleresimit, Komisioni i Pranimit perzgjedh kandidatet fitues, listen e te cileve ia propozon per miratim Pergjegjesit te Departamentit. Fitues shpallen kandidatet qe kane grumbulluar numrin me te madh te pikeve ne rend zbrites deri ne plotesimin e kuotes se parashikuar te pranimit. Pergjegjesi i Departamentit shpall vendimin e motivuar te pranimeve ose mospranimeve ne DND-ne Juridik .
- e. Ne kete faze Pergjegjesi i Departamentit i komunikon secilit kandidat vendimin e pranimit, mospranimit ose perfshirjes ne listen pritesë. Ankesat kunder vendimit te komunikuar behen ne Dekanatin e Fakultetit, i cili shpall vendimin e tij brenda 5 diteve nga paraqitja e ankeses.

Neni 26

Dokumentacioni i pranimit

Kandidati qe kerkon te ndjeke studimet per DND-ne Juridik duhet te dorezoje dokumentet e meposhtme:

1. Diplomen qe zoteron (autentike ose te fotokopjuar dhe te noterizuar).
2. Listen e notave (autentike ose te fotokopjuar dhe te noterizuar).
3. Certifikate lindjeje me fotografi
4. Curriculum vitae
5. Kerkese me shkrim dhe leter motivimi ku te shprehe qarte qellimin e ndjekjes se studimeve ne DND-ne Juridik .
6. Mandat pagese nga banka te takses se regjistrimit.

KREUV STUDENTET

Neni 27

Statusi i studentit

1. Kandidati fitues i konkursit te pranimit ka te drejte te ndjeke studimet ne vitin akademik per te cilin konkurroi nese regjistrohet ne Sekretarine mesimore brenda afateve te parashikuara. Me regjistrimin ai fiton statusin e studentit dhe te gjitha te drejtat qe burojne prej tij.
2. Statusi i studentit perfundon me marrjen e diplomes ose me perjashtimin e personit nga DND.

Neni 28

Te drejtat e studenteve

Studentet e DND- ne Juridik kane keto te drejta:

- a. Te udhehiqen nga rregulla dhe procedura te formuluar qarte dhe te justifikuar ne aspektin akademik.
- b. Te jene te mbrojtur nga diskriminimi i çdo lloji ose nga ndonje kriter i papershtatshem i vleresimit akademik.
- c. Te kene ne dispozicion te gjithe informacionin qe u takon per te gjitha çeshtjet akademike dhe veprimtarine e DND-ne Juridik .
- d. Te perdorin pajisjet e institucionit, sipas rregullave perkatese per te realizuar programin mesimor dhe punen e programuar ne aktivitetin e tyre shkencor, biblioteken dhe Internetin;
- e. Te paraqesin pikepamjet e tyre pa frike nga ndeshkimi.
- f. Te perfaqesohen ne organet drejtuese te fakultetit dhe te Universitetit .
Te marrin pjese ne vleresimin e veprimtarise se DND-ne Juridik .
Te refuzojne te kryejne detyra qe nuk lidhen me zhvillimin akademik dhe profesional.

Neni 29

Pergjegjesite e studenteve

Studentet e DND-ne Juridik kane keto pergjegjesi:

- a. Te njohin dhe te zbatojne Rregulloren e DND-ne Juridik dhe te Universitetit Justiniani i pare, kerkesat e planit dhe te programeve mesimore dhe te jene te vetedijshem per zbatimin e tyre, ne te kundert institucioni nuk mban pergjegjesi per pasojat qe mund te rrjedhin nga mosnjohja e tyre.
- b. Te sillen ne nje menyre te pjekur, profesionale, qytetare ne tere nderveprimet me drejtuesit, personelin akademik dhe administrativ, studentet e tjere dhe bashkepunetoret e DND-ne Juridik
- c. Te permbushin ne kohe te gjitha kerkesat dhe detyrimet e programeve mesimore, praktikes dhe tezes.
- d. Te kontribuojne ne zhvillimin e DND-ne Juridik dhe krijimin e nje klime pozitive ne institucion.
- e. Te respektojne kohen e pedagogeve.
- f. Te paguajne taksen e regjistrimit dhe tarifen e shkollimit ne afatet e caktuara.
- g. Te mbajne pergjegjesi per shkeljet e rregullave te DND-ne Juridik nga ana e tyre. Demi material qe mund t'i shkaktojne institucionit zhdemtohet ne masen qe e gjykon Komiteti Shkencor i DND-ne Juridik .

Neni 30

Pergjegjesite e DND-ne Juridik per studentet

1. DND-ne Juridik u jep studenteve gjithë informacionin e nevojshem lidhur me Rregulloren e DND-ne Juridik , strategjine e zhvillimit, kriteret e pranimit, planin dhe programet mesimore, rregullat e vleresimit, rregullat e praktikes, rregullat e mbrojtjes se' tezes, tarifen e shkollimit.
2. Respekton te gjitha kriteret profesionale, shkencore dhe pedagogjike per mesimdhenien, praktiken, kerkimin, vleresimin.
3. Nxist studentet te marrin pjese ne veprimtarite e DND-ne Juridik , fakultetit dhe universitetit.
4. U asiston studenteve ne plotesimin e kerkesave qe lidhen me zbatimin e planit mesimor.
5. Krijon kushtet e pershtatshme per realizimin e programit (siguron mjediset, rrjetin e informacionit, ve ne dsipozicion biblioteken, mjete mesimore dhe teknologjine elektronike).

KREU VI

MASAT DISIPLINORE

Neni 31

1. Shkelje e rregullave te DND-ne Juridik quhen te gjitha veprimet e kryera nga ana e subjekteve qe veprojne ne DND-ne Juridik dhe qe cenojne personalitetin e subjekteve te tjera qe veprojne ne DND-ne Juridik .
2. Si veprime te ndeshkueshme quhen falsifikimi i dokumenteve te ndryshme, kopjimi ne provime, kopjime ne punime shkencore, aktet e rrugacerise, te vjedhjes, shkelja e rregullores etj.
3. Ndaj personave qe kryejne keto veprime merren keto masa disiplinore:
 - a) verejtje me shkrim b) perjashtim nga studimet per nje vit c) perjashtim nga Universiteti.
4. Masa e parashikuar ne piken (a) merret nga Pergjegjesi i Departamentit. Masa e parashikuar ne piken b) merret nga Dekani me propozim te Pergjegjesit te Departamentit dhe masa e parashikuar ne piken c) merret nga Rektori me propozim te Dekanit te fakultetit.
5. Asnje ndeshkim nuk mund te zbatohet pa u degjuar me pare personi qe do te ndeshkohet.
6. Vendimet e i Dekanit mund te ankimohen prane Rektoratit brenda pese diteve nga dita e komunikimit te tyre. Ankimi i bere nuk pezullon zbatimin e mases.
7. Masat disiplinore per personelin akademik dhe administrativ merren sipas Kodit te Punes.

Neni 32

Tarifa e shkollimit

1. Tarifa e shkollimit per DND-ne Juridik propozohet nga Departamenti dhe miratohet nga instancat perkatese.
2. Studenti eshte' i detyruar te beje pagesen e tarifes se shkollimit ne daten e caktuar nga institucioni. Studentit qe nuk kryen pagesen e tarifes se shkollimit ne afatin e caktuar i hiqet e drejta per te vazhduar studimet.
3. Secili kandidat qe deshiron te regjistrohet per konkursin e pranimit ne DND-ne Juridik duhet te paguaje ne diten e regjistrimit nje tarife te caktuar. Kjo tarife regjistrimi eshte e pakthyeshme per kandidatet qe nuk fitojne te drejten e studimit. Fletepagesa e tarifes se regjistrimit duhet te shoqeroje dokumentin e aplikimit dhe te perfshihet ne dosjen e kandidatit.
4. Perdorimi i te ardhurave nga tarifa e shkollimit dhe tarifa e regjistrimit
 - a. Te ardhurat e siguruara nga tarifa e shkollimit perdoren per te mbuluar shpenzimet per sherbime operative, investime, shperblime te personelit akademik, te personelit administrativ te DND dhe per te mbuluar veprimtarite e DND-ne Juridik , te parashikuara ne nenin 7 te kesaj Rregulloreje.
 - b. Te ardhurat nga tarifa e regjistrimit per konkurrim perdoren per te mbuluar te gjitha veprimtarite per zhvillimin e konkursit te pranimit.
 - c. Perfitimi i studenteve nga pagesa e tarifes se shkollimit perfshin: dokumentet zyrtare per ta, shfrytezimin e bibliotekes, te internetit dhe pajisjet e tjera teknike dhe elektronike te institucionit. Kjo tarife nuk mbulon shpenzimet individuale te shkollimit, si shpenzimet per tekste, fotokopjim materialesh, vizita studimore.

KREU VII

VLERESIMII DND-ne Juridik

Neni 33

1. DND-ne Juridik kryen ne fund te cdo viti vleresimin e brendshem dhe vepron sipas rregullores se institucionit neni 43 i cili flet per menyren e ngritjes dhe te funksionimit te Sistemit te brendshem te sigurimit te cilesise (SBSC).
2. DND-ne Juridik kerkon akreditimin ne afatet e parashikuara me ligj.

KREU VIII

VULA ZYRTARE DHE LOGO

Neni 34

DND-ne Juridik do te perdore vulen zyrtare dhe logon e Fakultetit te Drejtesise Justiniani i Pare

KREU IX

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 35

1. Kjo rregullore mund te persoset e te korrigohet gjate punes, ne perputhje me zhvillimet dhe detyrat e reja qe merr persiper DND-ne Juridik .
2. Te drejten e interpretimit te kesaj Rregulloreje e ka dekani i Fakulteti te Drejtesise .